

Tiranë, më 13.12.2018

RAPORT I MONITORIMIT

PËR VERIFIKIMIN E ANKESËS TË DEPOZITUAR NË PLATFORMËN E BASHKËQEVERISJES, LIDHUR ME PROCEDURËN E NDJEKUR NGA DREJTORI I GJIMNAZIT "GRAMOZ PALUSHI" PASKUQAN, ZA KAMZË, PËR LARGIMIN E ZNJ. A. B. NGA POZICIONI I PUNËS SI MËSUESE FIZIKE

Mbështetur në Urdhrin Nr. 642, datë 08.10.2018 "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e ankesës të depozituar në Platformën e Bashkëqeverisjes, lidhur me procedurën e ndjekur nga drejtori i gjimnazit "Gramoz Palushi" Paskuqan, ZA Kamzë, për largimin nga pozicioni i punës si mësuese fizike, i znj. A. B., grupi i punës kreu verifikimet sipas objektit si më poshtë.

OBJEKTI

Verifikimi dhe vlerësimi i dokumentacionit në gjimnazin "G. Palushi" dhe në ZA Kamzë mbi çështjet e ngritura në ankesë dhe pretendimet e ankimueses.

METODOLOGJIA

- Takim me z. Abaz Hoxha, drejtor i gjimnazit "G. Palushi" Paskuqan.
- Takim me punonjësit e ZA Kamzë, z. Sulejman Keta dhe znj. Mimoza Dafa.
- Shqyrtim i dokumentacionit në gjimnazin "G. Palushi" dhe në ZA Kamzë lidhur me procedurat e ndjekura për largimin nga puna të mësueses Aurela Baça.

GRUPI I PUNËS

1. Besnik Rama
2. Holta Seferi
3. Albana Çelaj.

ANKESA DHE PRETENDIMET E ZNJ. AURELA BAÇA

[Redacted content]

Në ankesën e saj drejtuar ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Baça ka kërkuar:

1. Shqyrtimin e rastit dhe deklarin e pavlefshmërisë të akteve të ndërmarra nga drejtori i gjimnazit për konkursin për nëndrejtor dhe për largimin e znj. Baça për shkak të mungesës së orëve mësimore.
2. Vendosjen e të tre mësuesve të fizikës në vlerësim sipas kriterëve ligjore, përfshi këtu dhe nëndrejtorin e shkollës.
3. Hapjen e procedurave të konkurrimit për vendin e nëndrejtorit.

Ankesa e znj. Baça në portalin www.shqiperiaqeduam.al ka të njëjtën përmbajtje me atë drejtuar ministrit.

Me ankesën e datës 17.09.2018, protokolluar në MASR me nr. 9570 prot., datë 18.09.2018, znj. Baça i është drejtuar z. Vladimir Gjonaj, drejtor i Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MASR. Znj. Baça parashtron kundërshtimet e saj lidhur me shqyrtimin që i ka bërë DAR-ja e Qarkut Tiranë ankesës së saj të datës 24.08.2018 drejtuar ministrit të MASR-së. Sipas znj. Baça, DAR-ja e Qarkut Tiranë nuk ka shqyrtuar asnjë nga pretendimet e saj (në shkresën që i ka shkruar znj. Baça me nr. 1944/1 prot., datë 11.09.2018).

Në ankesën e saj të datës 17.09.2018, znj. Baça shton pretendime të tjera, veç atyre të ngritura në ankesën e saj të datës 24.08.2018:

- Nëndrejtori i shkollës e ka mesataren e notës 6.3, drejtori ia ka rrumbullakosur 7.
- Nëndrejtori ka pikë të barabarta me konkurrentin e dytë (76 pikë).
- Znj. Baça i janë njohur vetëm 7 kredite, ndërkohë që ka dorëzuar 15 të tilla.
- Znj. Baça ka qenë tri herë administrator në provime kombëtare, por nuk i është përlllogaritur asnjë pikë, ndërsa nëndrejtorit po.
- Znj. Baça i janë zhdukur një pjesë e certifikatave dhe kualifikimeve.
- Drejtori nuk ka përlllogaritur saktë klasat dhe normat mësimore për vitin shkollor 2018-2019: parashikoi 18 klasa, janë realisht 19 klasa.

GJETJE DHE KONSTATIME

1. Procedurat për emërimin e nëndrejtorit të gjimnazit “G. Palushi”

Me vendim nr. 3, datë 1.11.2017, drejtori i gjimnazit ka komanduar z. Blerim Deda në pozicionin e nëndrejtorit të shkollës.

Në datën 3.4.2018 është shpallur njoftim për vendin e lirë për nëndrejtor. Kanë konkurruar tre kandidatë: Blerim Deda, Elisabeta Muha dhe Aurela Baça. Znj. Baça pretendon se nota mesatare e z. Deda është 6.3, ndërsa drejtori ia ka rrumbullakosur me 7. Nga përlllogaritja e notave të diplomës universitare të z. Deda, rezulton se nota mesatare e tij është 6.8.

Znj. Baça pretendon që kandidatët Deda dhe Muha janë me pikë të barabarta (76 pikë secili). Sipas procesverbalit të datës 16.4.2018 mbi vlerësimin me pikë të kandidatëve për nëndrejtor, rezulton që kandidati Deda është renditur i pari me 77 pikë.

[REDACTED]

Lidhur me pretendimin e znj. Baça për vendosjen e të tre mësuesve të fizikës në vlerësim sipas kriterëve ligjore, përfshi këtu dhe nëndrejtorin e shkollës, në komisionin e vlerësimit të dosjeve në ZA Kamzë janë shqyrtuar dosjet e dy mësueseve, pasi nëndrejtori hyn në stafin drejtues të shkollës dhe, për sa kohë mban këtë pozicion, nuk konkurren për normë mësimore si mësues.

Në gjimnazin “G. Palushi” nuk janë rihapur procedurat e konkurrimit për vendin e nëndrejtorit, pasi nuk ka pasur ankime brenda afatit të përcaktuar në pikën VI.3 të kreut 1 të Udhëzimit Nr. 58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor”.

[REDACTED]

2. Norma mësimore për profilin e fizikës në gjimnazin “G. Palushi”

Vitin e kaluar shkollor, në gjimnazin “G. Palushi” kanë punuar dy mësues të profilit fizikë dhe nëndrejtori i shkollës, i po këtij profili. Për vitin shkollor 2018-2019, në këtë gjimnaz janë pakësuar orët e fizikës, për shkak të numrit të klasave dhe kurrikulës me zgjedhje në klasën e 12-të. Znj. Baça pretendon se drejtori nuk ka përllogaritur saktë klasat dhe normat mësimore për vitin shkollor 2018-2019: parashikoi 18 klasa, janë realisht 19 klasa.

Aktualisht, gjimnazi “G. Palushi” ka 643 nxënës të ndarë në 19 klasa gjithsej. Lënda e fizikës ka gjithsej 30 orë mësimi/javë (22 orë mbulohe nga mësuesja fituese e konkurrimit me dosje dhe 8 orë nga nëndrejtori i shkollës). Lënda “Teknologji” nuk është përzgjedhur nga nxënësit. Shpërndarja e normës mësimore për mësuesit është bërë në përputhje me Udhëzimin e MASR-së Nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet arsimi parauniversitar”.

3. Procedurat për konkurrimin me dosje të mësuesve të fizikës të gjimnazit “G. Palushi”

ZA Kamzë, me shkresën nr. 953 prot., datë 29.09.2018, pasi e informon për gjithë situatën e normave mësimore në gjimnazin “G. Palushi” për vitin shkollor 2018-2019 dhe për pretendimet që mësuesja Aurela Baça ka ngritur, i ka ofruar mundësinë e sistemimit

në profilin "Fizikë" në gjimnazin "Ibrahim Rugova" (gjimnazi më i madh në Kamzë) ose në shkollën 9-vjeçare "Halit Coka" Bathore.

ZA Kamzë e ka ftuar znj. A.B. për lëvizje paralele të detyruar. Znj. A.B. është paraqitur në ZA dhe ka refuzuar ofertat, duke mos nënshkruar edhe dokumentin përkatës.

ZA-ja, në datën 25.09.2018, ka miratuar vendimin nr. 76, datë 17.09.2018, të drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Halit Coka" për emërimin e znj. Baça mësuese definitive, pa pëlqimin e mësueses.

PËRFUNDIME

[Redacted text]

Pretendimi i znj. A.B. se nëndrejtori ka notën mesatare 6.3 nuk qëndron, pasi nota mesatare e tij është 6.8.

[Redacted text]

[Redacted text] "Palushi" nuk është bërë asnjë ankim për procedurat e emërimit të nëndrejtorit brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin përkatës.

Vendimi nr. 76, datë, 17.09.2018, i drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Halit Coka" për emërimin e znj. Baça mësuese definitive dhe miratimi i tij nga ZA-ja janë bërë pavarësisht refuzimit dhe mosparaqitjes në punë të znj. Baça.

Shpërndarja e normës mësimore për mësuesit në gjimnazin "G. Palushi" është bërë në përputhje me Udhëzimin përkatës.

REKOMANDIME

Nisur nga gjetjet, konstatimet dhe dokumentacioni i verifikuar, grupi i punës rekomandon:

1. Drejtori i gjimnazit "Gramoz Palushi" të rishikojë procedurën e emërimit të nëndrejtorit të shkollës në përputhje të plotë me Udhëzimin Nr. 58, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor".
2. Zyra Arsimore Kamzë të rishikojë vendimin Nr. 76, datë 17.09.2018 të drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Halit Coka" për emërimin e znj. Baça mësuese definitive, pasi ky vendim nuk është i mbështetur në Udhëzimin Nr. 38, datë 06.10.2015 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar".
3. Zyra Arsimore Kamzë të marrë masa për sistemimin e znj. Aurela Baça në punë në përputhje me Udhëzimin e MAS-it Nr. 38, datë 06.10.2015 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar".

GRUPI I PUNËS

Besnik Rama



Holta Seferi



Albana Çelaj

